



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2442/ 2 prot.,

Datë: 06.10.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Alb Gerald 2023” SHPK & “Samteks Makina, Insaat, Taahhut, tekstil, Imalat Sanayi ticaret LTD Sirketi” në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. *REF- 77564-08-16-2023*, me objekt “Blerje rroba pune ” me fond limit 13,290,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit OST SH.A.
- Ankimues:** Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “ Alb Gerald 2023” SHPK & “Samteks Makina, Insaat, Taahhut, tekstil, Imalat Sanayi ticaret LTD Sirketi”  
Rruga “Ramadan Sokoli”, Godina 36, Laprakë, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Sistemit të Transmetimit OST SH.A  
Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës Km. 9

Në datën 05.10.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2442 protokollit e Bashkimi të Operatorëve Ekonomikë “Alb Gerald 2023” SHPK & “Samteks Makina, Insaat, Taahhut, tekstil, Imalat Sanayi ticaret LTD Sirketi, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. *REF-77564-08-16-2023*, me objekt ‘*Blerje rroba pune*’ me fond limit: 13,290,000.0 (trembëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në 01.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit te Transmetimit OST SH.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Alb Gerald 2023” SHPK & “Samteks Makina, Insaat, Taahhut, tekstil, Imalat Sanayi ticaret LTD Sirketi.

Bazuar në gjurmën “b”, të pikës 4, të nenit 112, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*  
*b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”*.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “Alb Gerald 2023” SHPK & “Samteks Makina, Insaat, Taahhut, tekstil, Imalat Sanayi ticaret LTD Sirketi që kundërshton me anë të ankesës me nr. 2442/2023 prot., datë 05.10.2023 dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3471.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

*Nuk ka përmbushur pikën 2.2.1, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi BOE nuk ka paraqitur vërtetim të xhiros vjetore për vitet e kërkuara. Vërtetimi i vetëm i paraqitur nga OE “ALB-GERALD 2023” sh.p.k., nuk arrin vlerën e kërkuar në dokumentet e tenderit.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 06.10.2023.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**